Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Veçoritë antropometrike dhe aftësitë motorike		Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përfunduar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore, si dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; II. 7; III. 1. 5; V.9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Praktikon testimet dhe mëson mbi zhvillimin momental fizik.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kontrolli i zhvillimit motorik (inicialet)			
Fjalët kyçe: Aftësitë, kontroll, shpejtësia, forca e muskujve.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Përshkruan dhe krahason rezultatet motorike si dhe i komenton të gjeturat.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, kronometri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Njeriu dhe natyra.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Nxënësit/et bëhen rresht dhe njoftohen për njësinë mësimore.			
Hapi i dytë: Nxënësit/et bëhen rresht dhe presin në radhë për testime. - Testi parë: shpejtësi maksimale 60 metra. - Testi dytë: forca e muskujve të barkut. - Testi tretë: forca e muskujve të shpinës. - Testi katër: përkulje mbi duar. - Testi pestë: përkulshmëria. - Testi gjashtë: kërcimi në lartësi. - Testi shtatë: kërcimi në gjatësi.			

Hapi i tretë: Inkurajohen nxënësit/et që të merren me aktivitet fizik gjatë kohës së lirë.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim dhe krahasim me njëri-tjetrin.
REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE
Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sporte kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Udhëheqja e topit në futboll			
Fjalët kyçe: Udhëheqje, qëndrim, futboll, topi, pranim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Praktikon lëvizje për zhvillimin e elementit teknik të udhëheqjes.			
Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et kuptojnë rëndësinë e lojës së futbollit dhe përfitimet e transformimit motorik, si dhe antropometrik që marrin nga kjo lojë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizike.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et bëhen rresht dhe njoftohen për njësinë mësimore. Fillojnë me nxehtjen e trupit, sipas komandave dhe demonstrimit nga mësuesi/ja. - Përsosja e elementeve teknike themelore në lojën e futbollit janë faktorët më të rëndësishëm për përsosjen e mëtejshme të lojës. Futbolli nuk mund të luhet pa teknikën e udhëheqjes së topit. - Të shpjegohet llojet e udhëheqjeve (me trinën e brendshme dhe të jashtme) nga ana e mësimeve të nxënësit/es.			
Hapi i dytë: Demonstrohet udhëheqja e topit me trinën e brendshme nga ana e mësimeve të nxënësit/es.			

- Nxënësit/et vendosen me krahë nga vijat anësore të fushës së futbollit, në radhë njëri/a pas tjetrit/es me nga një top secili/a.
- Nxënësit/et fillojnë me udhëheqjen e topit me trinën e brendshme deri në fund të fushës.
- Në kthim vazhdon ushtrimi me trinën e jashtme.

Hapi i tretë:

- Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.
- Diskutim rreth gabimeve që paraqiten gjatë ekzekutimit të këtij elementi teknik.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Inkurajohen nxënësit/et që të përcjellin ekipin e futbollit të qytetit të tyre.


REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Pasimi i topit në vend dhe në lëvizje			
Fjalët kyçe: Pasim, vrapim, lëvizje, topi, gjatë, shkurt.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna dhe kupton mënyrat e pasimit të topit në vend dhe lëvizje.			
Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë teknikën e pasimit të topit me trinën e brendshme dhe të jashtme, si dhe me trinë të plotë në vend dhe në lëvizje. - Demonstroi drejt pasimin e topit në vend dhe lëvizje			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e futbollit, kone.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizik.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e trupit përmes ecjeve sportive, vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. Të shpjegohet llojet e pasimeve (në vend dhe lëvizje) nga ana e mësimeve nxënësit/es.			
Hapi i dytë: Demonstroi pasimi i topit në vend dhe lëvizje nga ana e mësimeve nxënësit/es. - Nxënësit/et vendosen në çifte, me krah nga vijat anësore të fushës së futbollit në radhë njëri/a pas tjetrit/ës me nga një top në çift. - Nxënësit/et fillojnë me pasimet në vend përballë njëri-tjetrit duke i përdorur trinën e plotë. - Nxënësit/et fillojnë me pasimet e topit në lëvizje duke vrapuar lehtë me trup nga goli.			

Hapi i tretë: Inkurajohen nxënësit/et që të merren me aktivitet fizik gjatë kohës së lirë.

- Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.
- Diskutim rreth gabimeve që paraqiten gjatë ekzekutimit të këtij elementi teknik.



DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Inkurajohen nxënësit/et që të përcjellin ekipin e futbollit të qytetit të tyre dhe të bëjnë kërkime të vazhdueshme në internet për lojën e futbollit.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et të ndarë në grupe bëjnë vlerësimin e grupeve dhe zgjedhjen më të mirë të grupit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathhtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathhtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teknika e pranimi të topit në Futboll			
Fjalët kyçe: Pranim, qëndrim, koka, gjoksi, topi.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna dhe kupton mënyrat e pranimi të topit në futboll. Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë teknikën e pranimi të topit me shputë, kokë dhe gjoks. - Demonstroi drejt pranimin e topit me shputë, kokë dhe gjoks.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e futbollit, kone.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizik.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e trupit përmes ecjeve sportive, vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet llojet e pranimeve nga ana e mësimeve nxënësit/es. Hapi i dytë: Demonstroi pranimi i topit në vend dhe lëvizje nga ana e mësimeve nxënësit/es. - Nxënësit/et vendosen në çifte, përballë njëri-tjetrit me nga një top në çift. - Nxënësit/et fillojnë me pasimet në vend përballë njëri-tjetrit duke përsëritur teknikën e mësuar nga java e kaluar.			

- Nxënësit/et fillojnë me duke pranuar topin gjatë pasimeve të njëri-tjetrit me shputë.
- Nxënësit/et fillojnë me duke pranuar topin gjatë pasimeve të njëri-tjetrit me kokë.
- Nxënësit/et fillojnë me duke pranuar topin gjatë pasimeve të njëri-tjetrit me gjoks.

Hapi i tretë:

- Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.
- Diskutim rreth gabimeve që paraqiten gjatë ekzekutimit të këtij elementi teknik.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Inkurajohen nxënësit/et që të përcjellin ekipin e futbollit të qytetit të tyre dhe të bëjnë kërkime të vazhdueshme në internet për lojën e futbollit.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et të ndarë në grupe bëjnë vlerësimin e grupeve dhe zgjedhjen më të mirë të grupit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sporte kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mbajtja e topit në futboll			
Fjalët kyçe: Përqendrim, topi, ekzekutim, mbajtje.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore			
Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme, si dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në futboll.			
Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë teknikën e mbajtjes të topit me shputë, kokë dhe gjoks.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e futbollit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizik.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e trupit përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet mënyrat e mbajtjes nga ana e mësimeve nxënës/es.			
Hapi i dytë: Demonstrohet pranimi i topit në vend dhe lëvizje nga ana e mësimeve nxënës/es. - Nga këndi i fushës së futbollit, nxënësi/ja mban topin me këmbën punuese, dhe vazhdon duke lëvizur atë në drejtimin e kundërt para. Pasi të arrijnë në këndin tjetër, kthehen në rrugën të cilën kaluan me mënyrën e njëjtë. - Fillimisht, nxënësit/et lëvizin topin përpara. Pastaj kthejnë topin me të njëjtën këmbë dhe vazhdon këtë ushtrim duke lëvizur nëpër fushë në këtë mënyrë. Ky ushtrim mund të bëhet edhe duke ndryshuar këmbët për të kontrolluar topin, duke e bërë atë edhe më efektive.			

- Nxënësit/et mbajnë topin me të dy këmbët, mund të praktikojnë ushtrimin e kontrollit të topit me të dy këmbët, duke e ndryshuar këmbën dhe duke u munduar të mbajnë kontrollin e topit.
- Nxënësit/et ndryshojnë drejtimin e topit, mund të bëjnë ushtrimin duke e kthyer topin në anët e ndryshme dhe duke ndjekur një rrugë të caktuar.
- Nxënësit/et ndryshojnë shpejtësinë e topit, duke e shtyrë topin me një këmbë dhe pastaj duke e kaluar në anën tjetër me këmbën tjetër.
- Nxënësit/et kontrollojnë topin me trup, duke e hedhë topin në ajër dhe duke e kontrolluar atë me gjoks, gjunjë dhe këmbë.

Këto ushtrime janë vetëm disa nga ushtrimet që mund të ndihmojnë në mësimin e mbajtjes së topit në futboll. Është gjithashtu e rëndësishme që të praktikoni ato me përkushtim dhe konsistencë për të zhvilluar dhe sigurinë në mbajtjen e topit.

Hapi i tretë:

- Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.
- Diskutim rreth gabimeve që paraqiten gjatë ekzekutimit të mbajtjes së topit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në shtëpi të bëjnë ushtrimet e mbajtjes së topit me këmbë, gjoks dhe gjunjë.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sporte kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Goditja e topit në gol.			
Fjalët kyçe: Trinë, topi, goli, e brendshme, e jashtme, e plotë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në futboll.			
Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë teknikën e goditjes së topit në gol.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e futbollit, konet.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizik.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e trupit përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet mënyrat e gjuajtjes së topit në gol nga ana e mësimdhënësit/es.			
Hapi i dytë: Demonstrohet gjuajtja e topit në gol nga ana e mësimdhënësit/es. - Gjuajtje e topit nga këndi i caktuar: Ky ushtrim të bëhet nga këndi i fushës dhe mund të përfshijë gjuajtjen e topit në portë nga këndi i djathtë ose i majtë. Të mundohen nxënësit/et që ushtrimin ta bëjnë me saktësi dhe forcë për të arritur të goditet topi me sukses në portë nga këndi. - Gjuajtja e topit në vija të caktuara: Ky ushtrim përfshin vëmendjen në saktësinë e gjuajtjes dhe mund të bëhet në fushë me vija të caktuara, ku lojtari duhet të gjuajë topin në vendin e duhur. - Gjuajtja e topit me kokë: Nxënësi/ja duhet të praktikojë gjuajtjen e topit me kokë në mënyrë që të jenë të sigurt dhe të saktë në goditjen e topit me kokë. Topi të hidhet nga mësuesi/ja drejt nxënësit/et në mënyrë që nxënësi/ja të realizojë goditjen.			

Hapi i tretë:

Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.

- Diskutim rreth gabimeve që paraqiten gjatë ekzekutimit të goditjes së topit në portë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në lagje të praktikojnë goditjen e topit në portë gjatë lojës së futbollit me shokët/shoqet e lagjes.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sporte kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mbrojta nga portieri në futboll			
Fjalët kyçe: Mbrojta, topi, goli, portier, këndi. .			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme, si dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në futboll.			
Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë mbrojtjen në futboll duke luajtur rolin e portierit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e futbollit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizik.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e trupit përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet njësia mësimore nga ana e mësuesit.			
Hapi i dytë: Demonstrojnë lëvizjet e portierit nga ana e mësuesit. - Ushtrim për pozicionimin e portierit në portë: nxënësi/ja vendoset në pozicion e duhur në portë. Ushtrimet e pozicionit përfshijnë përdorimin e portave duke mbajtur qëndrimin e duhur të gatshëm për mbrojtje të penaltive apo edhe goditjes së topit nga situatat e lojës. - Ushtrimi i kapjes së topit me dorë: Nxënësit/et të jenë në rresht për të realizuar kapjen e topit me duar në portë në kënde të ndryshme, të cilat goditje i realizon mësuesi. Ushtrimi mund të përfshijë praktikimin e kapjes së topit në lartësi të ndryshme dhe në pozicionet e ndryshme të trupit. - Ushtrimi i kapjes së topit nga lartë: Ushtrimet e kapjes së topit nga lartë mund të përfshijnë praktikimin e kapjes së topit në lartësi të ndryshme dhe në pozicionet e ndryshme të trupit.			

- Ushtrimi i ndalimit të golit me këmbë: Ushtrimet e ndalimit të topit të realizohen nga nxënësit/et në zhvendosje të shpejtë me këmbë për të arritur topat që janë larguar nga zona e portës. Realizimi i goditjes së topit në portë nga ana e arsimtarit, ndërsa nxënësit/et të realizojnë me radhë lëvizjet e ndalimit të topit me këmbë.

Hapi i tretë:

Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.

- Diskutim rreth gabimeve që mund të bëhen gjatë mbrojtjes në futboll.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Gjatë lojërave të zhvilluara me shokët, të luajë edhe pozitën e portierit.
--

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Qëndrimet në lojën e volejbollit.			
Fjalët kyçe: Qëndrim, topi, ulët, mesëm, lart.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në volejboll. Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë qëndrimet në lojën e volejbollit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e volejbollit, konet.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e trupit përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet njësia e re mësimore nga ana e mësuesit. Hapi i dytë: Të demonstrohet qartë dhe mirë qëndrimi i ulët nga mësuesi: - Nxënësit/et të shpërndarë në palestër në hapësira të ndryshme, dhe të ekzekutojnë qëndrimin ulur pa prezencën e topit. - Nxënësit/et ekzekutojnë qëndrimin ulur me top. Të demonstrohet qëndrimi i mesëm nga ana e mësuesit: - Nxënësit/et të shpërndarë në palestër dhe të ekzekutojnë qëndrimin e mesëm pa top. - Nxënësit/et të ekzekutojnë qëndrimin e mesëm me top. Të demonstrohet qëndrimi i lartë në volejboll nga ana e mësuesit: - Nxënësit/et të ekzekutojnë qëndrimin e lartë pa top në hapësira të ndryshme të palestrës. - Nxënësit/et ekzekutojnë qëndrimin e lartë me top.			

- Nxënësit/et të ndarë në çifte duke ia hedh topin njëri-tjetrit dhe duke përsëritur 3 llojet e qëndrimeve.

Hapi i tretë:

Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.

- Diskutim rreth gabimeve që mund të bëhen gjatë praktikimit të qëndrimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të shikojnë një ndeshje volejboli në *Youtube*.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shërbimi shkollorë dhe tenis			
Fjalët kyçe: Qëndrim, topi, ulët, mesëm, lart.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në volejboll. Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë qëndrimet në lojën e volejbollit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e volejbollit, rrjeta e volejbollit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e trupit përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet njësia e re mësimore nga ana e mësuesit. Hapi i dytë: Të demonstrohet shërbimi shkollor nga mësuesi: - Nxënësit/et në kolonë njëri pas tjetrit, nga mesi i gjashtëmetërshit të fushës së volejbollit fillojnë me ekzekutimin e shërbimit shkollorë (mësuesi/ja përcjell secilin nxënës duke ndihmuar verbalisht në ekzekutimin e elementit), deri në 5 përsëritje secili. Të demonstrohet shërbimi tenis nga mësuesi: - Nxënësit/et në kolonë njëri pas tjetrit nga mesi i gjashtëmetërshit fillojnë ekzekutimin e elementit teknik të shërbimit tenis (mësuesi/ja përcjell secilin nxënës duke ndihmuar verbalisht që të ndihmojë secilin nxënës në mënyrë që të përvetësojnë nxënësit/et sa më mirë shërbimin). - Luajnë volejboll duke u përqendruar te shërbimi (zgjedhje e llojit të shërbimit të bëhet nga vetë nxënësi)			

Hapi i tretë:

Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.

- Zgjatje e muskujve dhe rregullim i frymëmarrjes.
- Diskutim rreth shërbimeve të mësuara gjatë orës mësimore

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të shikojnë një ndeshje volejboli në *Youtube*.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathhtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathhtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Pasimi dhe pranimi i topit me çekan			
Fjalët kyçe: Pasimi, pranimi, çekan, top, volejboll.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathhtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në volejboll.			
Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë dhe përvetësojnë pasimin dhe pranimin e topit me çekan			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e volejbollit, rrjeta e volejbollit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehtim e muskujve përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet njësia e re mësimore nga ana e mësuesit.			
Hapi i dytë: Të demonstrohet pasimi dhe pranimi i topit me çekan: - Të vendosen nxënësit/et në çift përballë njëri-tjetrit (njëra-tjetrës) brenda fushës së volejbollit dhe me nga një top për secilin çift. - Nxënësi/ja i/e parë e hedh topin në drejtim të nxënësit/et të dytë dhe ky/kjo i/e fundit e pranon dhe pason në drejtim të shokut përballë topin. - Fillojnë pasimin dhe pranimin e topit me çekan duke ia pasuar më pas shokut. - Vazhdon me pranimin dhe pasimin e topit me çekan pa ndërpre (në formë loje). - Nxënësit/et të bëhen në 4 çifte njëri pas tjetrit në kolonë, dhe fillojnë pasimin e topit me dy duar nga lartë dhe pas pasimit të kalojnë në fund të kolonës.			

Luajnë në të gjithë fushën e volejbollit duke përdorur vetëm pasimin dhe pranimin e topit me çekan, dhe duke u munduar të fitojnë pikën. Në fund shpallet ekipi fitues.

Hapi i tretë:

- Zgjatje e muskujve.
- Diskutim rreth gabimeve të ekipit që nuk e fitoi lojën.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të shikojnë një ndeshje volejboli në *Youtube* me përqendrim te lojtarët e pranimin.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bëjnë vetëvlerësim bashkë me mësuesin/en. Secili/a nga nxënësit/et mund të luajë në rolin e pranuesit gjatë garave shkollore dhe komunale.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sporte kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Pasimi i topit me gishta në volejboll			
Fjalët kyçe: Pasimi, topi, gishtat, krahët, qëndrim			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në volejboll. Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë dhe dhe përvetësojnë pasimin e topit me gishta në volejboll.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e volejbollit, rrjeta e volejbollit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e muskujve përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit duke mbajtur topin e volejbollit në duar. - Të shpjegohet njësia e re mësimore nga ana e mësuesit. Hapi i dytë: Të demonstrohet dhe shpjegohet pasimi i topit me gishta nga mësuesi: - Të vendosen nxënësit/et në çift përballë njëri-tjetrit brenda fushës së volejbollit dhe me nga një top për secilin çift. - Nxënësi/ja i/e parë e hedh topin në drejtim të nxënësit/es të dytë dhe ky/kjo i/e fundit e kap topin me dy duar nga lart (e ndalon topin) dhe vazhdon ushtrimin anasjelltas, - Fillojnë pasimin e topit me dy duar nga lart fillimisht duke ia pasuar vetes, pastaj shokut. - Vazhdon me pasimin e topit me dy duar nga lartë pa ndërpre (në formë loje).			

- Nxënësit/et të bëhen në 4 çifte njëri pas tjetrit në kolonë, dhe fillojnë pasimin e topit me dy duar nga lartë dhe pas pasimit të kalojnë në fund të kolonës. Luajnë në të gjithë fushën e volejbollit duke përdorur vetëm pasimin e topit me gishta nga lartë, dhe duke u munduar të fitojnë pikën. Në fund shpallet ekipi fitues.

Hapi i tretë:

- Diskutim rreth gabimeve të bëra gjatë lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të shikojnë një ndeshje volejboli në *Youtube* duke u përqendruar te roli i pasuesit.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bashkë me mësuesin bëjnë vetëvlerësim duke u munduar të perceptojnë se cili nga nxënësit/et mund të orientohet në sportin e volejbollit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjuajtja në volejball			
Fjalët kyçe: Pasimi, topi, gishtat, krahët, qëndrim			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në volejball. Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë dhe përvetësojnë gjuajtjen në volejball.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e volejbollit, rrjeta e volejbollit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e muskujve përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet njësia e re mësimore nga ana e mësuesit. Hapi i dytë: Të demonstrohet dhe shpjegohet gjuajtja në volejball nga mësuesi: - Nxënësit/es të shpërndarë/a në fushë bëjnë përsëritjen e hapit të gjuajtjes në volejball. - Nxënësit/es në dy grupe në kolonë. Njëri/a nga nxënësit/et e grupit duhet të hedhë topin në ajër dhe tjetri duhet të gjuajë në drejtimin tjetër. Pas gjuajtjes, nxënësi/ja kalon në hedhjen e topit. - Nxënësit/et në kolonë përballë rrjetës, nga pozita 4 ekzekutojnë gjuajtjen nga pasimi (pasimin e ekzekuton mësuesi). - Luajnë në të gjithë fushën e volejbollit duke përdorur të gjitha elementet teknike në formë gare. Në fund shpallet ekipi fitues.			

Hapi i tretë:

Diskutim rreth gabimeve të bëra gjatë lojës për ekipin që nuk e fitoi lojën.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të shikojnë një ndeshje volejboli në *Youtube* duke u përqendruar te gjuajtja.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bashkë me mësuesin bëjnë vlerësim dhe vetëvlerësim duke u munduar të perceptojnë se cili nga nxënësit/et e ka përvetësuar teknikën e gjuajtjes më mirë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënit të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Blloku në volejboll			
Fjalët kyçe: Bllok, topi, rrjeta, krahët, kërcim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në volejboll. Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë dhe përvetësojnë bllokun në volejboll.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat e volejbollit, rrjeta e volejbollit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë me nxehjen e muskujve përmes vrapimeve dhe ushtrimeve të formimit. - Të shpjegohet njësia e re mësimore nga ana e mësuesit. Hapi i dytë: Të demonstrohet dhe shpjegohet ekzekutimi i bllokut në vend dhe me një hap nga mësuesi/ja: - Nxënësit/et vendosen në mes të fushës në kolonë përballë rrjetës të gatshëm për bllok, ndërsa mësuesi/ja me një top volejbollit të ngritur lartë mbi rrjetë, - Nxënësit/et në radhë përgatiten për bllok duke ngritur duart lart mbi topin e mbajtur nga mësuesi/ja me radhë njëri pas tjetrit. - Nxënësit/et në çift dhe të vendosen përballë rrjetës me një top, njëri e mban topin lart mbi rrjetë, ndërsa tjetri ekzekuton bllokun deri në 5 herë, pastaj të ndërrojnë rolet. - Të njëjtat ushtrime por vetëm me një hap në të djathtë, edhe në të majtë.			



- Nxënësit/et luajnë mes tyre, duke përdorur të gjitha elementet teknike në formë gare. Në fund shpallet ekipi fitues.

Hapi i tretë:

Diskutim rreth gabimeve të bëra gjatë lojës për ekipin që nuk e fitoi lojën.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të shikojnë një ndeshje volejboli në *Youtube* duke u përqendruar te blloku.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et bashkë me mësuesin bëjnë vlerësim dhe vetëvlerësim duke u munduar të perceptojnë se cili nga nxënësit/et e ka përvetësuar teknikën e bllokut më mirë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale		Rezultati i të nxënës të temës: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I. 6; III. 3, 6, 8; V. 4, 10; VI. 3, 5, 6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe liston rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive, si dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kapja e topit në lojën e hendbollit			
Fjalët kyçe: Bllok, topi, rrjeta, krahët, kërcim.			
Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore Nxënësi/ja: - Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në hendboll. Kriteret e suksesit: - Nxënësit/et demonstrojnë dhe përvetësojnë kapjen e topit në hendboll.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, topat, goli i lojës së hendbollit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: - Nxënësit/et fillojnë fillojnë me nxehjen e muskujve me top në çift përballë njëri-tjetrit duke e hedhur topin në mes tyre në mënyra të ndryshme. - Ushtrime të formimit. - Të shpjegohet njësia e re mësimore nga ana e mësuesit.			
